

Übersetzungshilfe Albanisch

# PËRSHTATJA

## NË QENDRAT TONA DITORE EVANGJELISTE

Përshtatja zhvillohet në përputhje me gjetjet shkencore mbi zhvillimin e fëmijëve, me nevojat e familjeve dhe realiteteve të tyre kulturore.

### Lidhja në mënyrë të sigurt dhe eksplorimi i botës me kuriozitet *...është e njëjtë për të gjithë fëmijët*

**Këto janë parimet për cilat VEKiS qëndron me konceptet pedagogjike në qendrat e saj ditore evangjelite për fëmijë**

**Të dashur prindër dhe kujdestarë ligjorë!**

Jemi të kënaqur t'ju urojmë mirëseardhjen juve dhe fëmijës tuaj në njërin nga qendrat tona ditore për fëmijë.

Me vizitën në njërin nga qendrat ditore për fëmijë për fëmijën tuaj nis një fazë tjetër e re e jetës. Qendrat ditore për fëmijë përbëjnë fillimin në një institucion komuniteti dhe, kështu, pikën fillestare në sistemin tonë arsimor.

**Për t'ju dhënë fëmijëve tuaj siguri dhe për të ndërtuar besim për të eksploruar "botën", është e rëndësishme që të vazhdojmë të mbështesim aftësinë e fëmijës për të krijuar marrëdhënie dhe për t'u lidhur në qendrat tona ditore. Për këtë arsye **përshtatja** në qendrën ditore mund të bëhet **nën shoqërimin** e një prindi ose një personi tjetër kujdestar kryesor.**

**Këtë e bëjmë të mundur për ju! Dhe ju do të shoqëroheni dhe këshillohen nga personel pedagogjik i trajnuar.**

**Aftësia e marrëdhënies dhe lidhjes** nënkupton lidhjen emocionale midis fëmijës dhe kujdestarëve të tij kryesorë (prindërve), e cila zhvillohet që në lindje, në një marrëdhënie të besueshme për fëmijën. Kjo është një kërkesë thelbësore për zhvillimin social, emocional dhe njohës të një fëmije.

**Sjellja e lidhjes** aktivizohet kur fëmijët sinjalizojnë (duke u mbajtur, shtrënguar, qarë, thirrur) se ata kanë nevojë për afërsi dhe ngushëllim, se ata dëshirojnë që të qetësohen, se ata dëshirojnë të krijojnë një afërsi mbrojtëse me një person të afërt.

Këtë nevojë bazë fëmijët e kanë në situata të përditshme, si për shembull kur janë të lodhur, ose kur përjetojnë diçka të re/të panjohur.

Në atë moment fëmija dëshiron t'i kthehet ndjesia e sigurisë dhe ka nevojë për personin **e tij** kujdestar. Fëmijët që **ndihen të sigurt dhe mirë eksplorojnë**, d.m.th. përpiqen të njohin ambientin përreth. Marrëdhëniet e qëndrueshme midis fëmijës dhe të rriturve janë **baza e proceseve të arsimimit**.

## Sfida në situatat e reja...

**Kalimi i parë nga shtëpia në qendrën ditore lidhet me kërkesa të reja për të gjithë personat e përfshirë, si për shembull:**

- Fëmijët përjetojnë mungesën e personit kujdestar, pra mungesën tuaj! Dhe ndërtojnë marrëdhënie të tjera.
- Ju, si prindër, mësoni të besoni se fëmija juaj ndihet mirë në qendrën ditore, ky është një proces shkëputjeje, i cili kërkon shumë prej jush.
- Fëmijët, ndoshta po përjetojnë për herë të parë një ambient të re me:
  - një ritëm ditor të ndryshuar
  - me vakte dhe ushqime të reja
  - një vend të ri fjetjeje
  - volum tjetër, shumë erëra, atmosferë e re e dhomës
  - ...dhe papritur: shumë fëmijë!



### **E rëndësishme për ju si prindër\*:**

Ju si prindër ju nevojitet besim që fëmija juaj është në duar të mira. Ju futeni në një partneritet edukimi dhe lejoni që fëmija juaj të përjetojë afërsi dhe përzemërsi nga një personel pedagogjik në qendrën ditore. Është e rëndësishme që ju të dini se ju jeni dhe mbeteni eksperti për fëmijën tuaj dhe **nuk** mund të zëvendësoheni.

\*Adresimi prindër i referohet gjithashtu edhe personave kujdestarë shoqëruar

## Fazat e përshtatjes



**Specialistët pedagogjikë i japin përshtatjes kuadrin profesional, duke formësuar përshtatjen e fëmijës suaj me ju mbi bazën e modeleve të përshtatjes shkencore dhe të bazuara. Theksi vendoset mbi individualitetin e secilit fëmijë, që do të thotë: për çfarë ka nevojë fëmija juaj?!**

### **Juve ju propozohet një fazë bazë 3 ditore:**

Sipas gjetjeve shkencore, krijimi i një marrëdhënieje të re në një ambient fillimisht të huaj te fëmijët në moshën deri në 3 1/2 vjeç zgjat, si rregull, midis 6 dhe 14 ditë. Prindërit mbeten personat kryesorë të lidhjes të fëmijës. Në ditën e 1-rë një prind e shoqëron fëmijën në qendrën ditore. Mbi bazën e një pyetësori janë diskutuar dhe shënuar me shkrim informacione mbi zakonet dhe ritualet e fëmijës. Që nga kjo bisedë fëmija është i ndjeshëm që po zhvillohet një ndërveprim midis prindit dhe personelit pedagogjik. Në 3 ditët e para ju qëndroni maksimumi 2 orë me fëmijën në ambientin e ri. **Këtu është thelbësore që personeli pedagogjik ju përjeton kur merreni me fëmijën tuaj, me qëllim që t'i mundësohet fëmijës suaj që të krijojë zakone të njohura më vonë.**

**Kjo periudhë përshtatjeje ndërtohet në ecurinë ditore normale të qendrës ditore dhe përcaktohet në planin e shërbimit, pasi përshtatja është një kohë intensive për personelin. Në varësi të situatës personale mund të ndodhin shtyrje.**

Në këtë fazë bazë të përshtatjes, personeli pedagogjik merr kontakt me fëmijën në përputhje me sinjalet e fëmijës, por pa e shtyrë atë. Kontakti fizik midis edukatorëve dhe fëmijës realizohet vetëm kur fëmija e dëshiron dhe e sinjalizon atë. Gjithnjë e më shumë prindi merr një rol pasiv. Në këtë periudhë **nuk** bëhet përpjekje ndarje dhe veprimet e përkujdesjes merren përsipër nga prindi ose personi kujdestar.

**Është parashikuara ecuria e mëposhtme, e cila orientohet në vazhdim në mënyrë individuale, mbi bazë të asaj që sinjalizon fëmija.**

### **Përpjekja e parë e ndarjes si rregull në ditën 4:**

Kur fëmija luan dhe është i zënë, natyrisht thoni mirupafshim, por qëndroni në qendër. Ndarja zgjat rreth një gjysmë ore. Kur fëmija pranon me vetëdije se ju jeni larguar nga dhoma dhe vazhdon të jetë i zënë me diçka, atëherë është realizuar me sukses përpjekja e parë e ndarjes. Nëse fëmija nuk qetësohet dhe qan pasi të jeni larguar nga dhoma, kthehuni në dhomë. Nëse nevojitet, një përpjekje tjetër ndarje mund të bëhet ditën tjetër.

### **Faza e stabilizimit si rregull duke filluar nga dita e 5-të**

Përpjekja e ndarjes zgjerohet. Nëse fëmija juaj ndihet mirë dhe bën një përshtypje të ekuilibruar, personeli pedagogjik merr përsipër veprimin e përkujdesjes, në fillim së bashku me ju.

**Në javën e 2-të** qëndrimi zgjerohet më tej dhe periudha pa prind rritet. Sipas mundësisë, prindi qëndron më tej në qendër.

**Faza përfundimtare:** Arrihet me sukses një ndarje e vetëdijshme e prindit. Prindi largohet nga qendra, por është i arritshëm.

Bihet dakord në mënyrë individuale se cilat kohë janë të mjaftueshme për fëmijën. Kur fëmija mund të përshtatet hap pas hapi me ritmin e qendrës ditore dhe specialistët pedagogjikë si dhe grupi i fëmijëve pranohen si bazë e sigurt, përshtatja ka përfunduar me sukses.



## Informacione të rëndësishme për prindërit:

### Ju mbështetni fëmijën tuaj nëse merrni parasysh sa më poshtë:

- përshtatja kurrë nën presion kohe
- reagoni pozitivisht ndaj afrimit dhe kontaktit pamor të fëmijës suaj, pa marrë kontakt nga ana juaj
- mos e shtyni fëmijën tuaj që të bëjë diçka ose të largohet prej jush
- mos u merrni me fëmijët e tjerë, pasi kjo e acaron fëmijën tuaj
- mos u ndjeni përgjegjës për rregullat në qendër
- kohët e rregullta të sjelljes dhe marrjes ia bëjnë fëmijës suaj më të lehtë hyrjen, sepse një ecuri ditore **e strukturuar** i jep siguri fëmijës suaj
- ndarja dhe rikthimi i japin fëmijës suaj besueshmëri dhe besim
- në situatën e sjelljes dhe marrjes pas përshtatjes merrni në konsideratë fëmijët e tjerë, për të cilët nuk jeni person kujdestar, duke mos qëndruar në dhoma
- objektet kalimtare të tilla si biberonët, peshqiri i butë ose lodrat e pelushit janë të dëshiruara dhe ndihmojnë fëmijën tuaj.
- siguroni arritshmërinë tuaj për personelin e qendrës ditore!

### Qëllimi i përshtatjes së butë:

- lehtësimi i situatës së re për fëmijën
- ndërtimi i besimit ndaj fëmijës ndërsa personi kujdestar i besuar është afër dhe i jep siguri fëmijës
- fëmija takohet me fëmijë të tjerë, fëmijët mbështesin njëri-tjetrin
- njohja e fëmijës në veçoritë dhe veçantitë e tij
- ndërtimi i një marrëdhënieje besimi midis prindërve dhe edukatorëve
- parandalimi i konkurrencave
- vendosja e gurit të themelit për një bashkëpunim të gjatë dhe të besueshëm në interes të fëmijës!

### ...krahas kësaj...

#### fëmijët mësojnë në qendër ditore?!



- Të sillen me shumë fëmijë në komunitet
- Të krijojnë shoqëri
- Të përjetojnë efektshmërinë personale; unë jam i rëndësishëm dhe merrem shumë seriozisht!
- Të shprehin nevojat personale
- Të përballojnë zënka dhe konflikte
- Të thonë JO dhe të mbrohen; të marrin ndihmë
- Pasoja pedagogjike të kuptimta në rast të shkeljeve të rregullta
- Të zbulojnë veten dhe trupin e tyre
- Përdorimin e tualetit në një qendër komuniteti
- Të zbulojnë trupin e tyre dhe të perceptojnë funksionet fizike
- Të futen në role të tjera dhe të provojnë veten; identiteti i Unit forcon vlerësimin për veten dhe zhvillohet që nga moshë 3 vjeç!

**Të gjitha këto dhe shumë gjëra tjera bëjnë pjesë të zhvillimit të identitetit në moshën e kopshtit të fëmijës!**